

FJALA E DEPUTETIT ILIR NDRAXHI

E ENJTE 24 SHKURT 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji, që po diskutojmë sot, ka qëllim aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për kontrollin dhe dëmet në sistemet e mbrojtjes antivegetative në anije, e vitit 2001, e cila synon të reduktojë ose të eliminojë efektet negative në mjedisin detar dhe shëndetin e njeriut të shkaktuar nga sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet. Projektligji është në përputhje me dispozitat përkatëse të Kushtetutës, si dhe ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”. Për sa i përket aspektit procedural, është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Është vërtetuar se bojërat kundër ndotjes për të veshur fundet e anijeve dëmtojnë gjallesat detare, siç janë molusqet, algat, si dhe ngadalësojnë lëvizjet e anijes duke rritur konsumin e karburantit. Studimet kanë treguar se këto përbërje vazhdojnë në ujë duke dëmtuar mjedisin detar, gjallesat detare, ndoshta, duke hyrë në ushqimin e tyre. Nga kjo del se përdorimi i sistemit të mbrojtjes antivegetativ për anijet është i nevojshëm, me qëllim parandalimin e krijimit të organizmave në sipërfaqen e anijeve dhe ka një rëndësi kritike për efikasitetin e tregtisë, transportin dhe pengimin e përhapjes së organizmave të dëmshme ujore dhe patogjenëve. Konventa u kërkon palëve të ndalojnë ose të kufizojnë përdorimin e sistemeve të dëmshme antindotje në anijet që mbajnë flamurin e tyre, si dhe në anijet që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e tyre, por që veprojnë nën autoritetin e tyre, si dhe të gjitha anijet që hyjnë në porte, kantiere detare ose terminale në detet e palëve të treta.

Konkretisht, sipas parashikimeve të kësaj konvente, anijeve me 400 tonë bruto, të angazhuara në udhëtime ndërkombëtare, u kërkohet t’i nënshtrohen një studimi fillestar para se të vihen në shërbim ose para se të lëshohet certifikata ndërkombëtare e sistemit antindotje për herë të parë. Nga një studim rezulton se sistemet antindotës ndryshohen ose zëvendësohen. Anijet me gjatësi 24 metra ose më shumë se 400 tonë bruto, të angazhuara në udhëtime ndërkombëtare, do të duhet të mbajnë një deklaratë mbi sistemin antindotës të nënshkruar nga pronari ose agjenti i autorizuar. Ky projektligj i vjen si detyrim Shqipërisë në statusin e anëtarit të Organizatës Ndërkombëtare detare IMO, për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë për plotësimin e standardeve përkatëse ndërkombëtare të detarisë. Ky projektligj është një kontribut tjetër i shtuar për mbrojtjen e gjallesave detare dhe sjell përmirësim në mjedisin ujor e në ujërat tona detare. Dua të theksoj se zbatimi i këtij projektligji nuk do të ketë efekte financiare në buxhetin e shtetit. Duke ju falënderuar, ju ftoj që ta votojmë këtë projektligj. Falemnderit!